



REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVA
KOSOVA CUMHURIYETI
Komuna e Prizrenit • Opština Prizren
Prizren Beledijesi
Kryetari i Komunës • Predsednik Opštine
Belediye Başkanı

01 Nr. 409/25 Dt. 09.07.2025



Prizreni, 09.07.2025	
Zyrtarë pranimit	Nr. i protokolit
308	01-413

Komuna e Prizrenit

Universiteti "Ukshin Hoti" Prizren

MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI

NDËRMJET

**KOMUNËS SË PRIZRENIT, PËRFAQËSUAR NGA KRYETARI
Z. SHAQIR TOTAJ**

DHE

**UNIVERSITETIT "UKSHIN HOTI" PRIZREN, PËRFAQËSUAR NGA REKTORI,
Z. MENTOR ALISHANI**

KORRIK, 2025

Neni 1

Fushëveprimi

Fushëveprimi i kësaj marrëveshje është pajtimi i palëve në angazhimin e përbashkët për bashkëpunim në fuqizimin e Universitetit "Ukshin Hoti" në Prizren (më tej: Universiteti) , përmes mbështetjes në organizimin e aktiviteteve shkencore dhe aktiviteteve tjera që organizon Universiteti. Qëllimi i kësaj marrëveshje është mbështetja e Universitetit në bashkëorganizimin dhe mbarëvajtjen e Shkollës Verore Ndërkombëtare 2025, si aktivitet i cili kontribuon në ndërkombëtarizimin e Universitetit si dhe në realizimin e misionit dhe vizionit të tij si institucion i arsimit të lartë në ofrimin e edukimit cilësor në përputhje me kërkesat e tregut të punës dhe komunitetit ku vepuron në nivel lokal, kombëtar dhe më gjerë.

Neni 2

Objekti i marrëveshjes

1. Objekti i kësaj marrëveshje, përfshin të drejta dhe obligime reciproke, duke pasur parasysh fushëveprimin dhe vullnetin e përbashkët të palëve nënshkruese.
2. Palët pajtohen që ta mbështesin njëra tjetrën për çështjet si në vijim:
 - 2.1. Komuna e Prizren në bazë Kërkesës së parashtruar nga Universiteti "Ukshin Hoti" në Prizren, më datë 25.06.2025, merr obligim që të mbështes Universitetin "Ukshin Hoti" në Prizren në bashkëorganizimin dhe mbarëvajtjen Shkollës Verore Ndërkombëtare 2025, e cila do të mbahet nga data 30 korrik deri 8 gusht 2025, në vlerë deri 10,000 Euro (Shpenzimet të ndryshme të faturave si: ushqim, pije, akomodim dhe shërbime)
 - 2.2. Universiteti "Ukshin Hoti" në Prizren, merr obligim që në kuadër të aktiviteve të Shkollës Verore Ndërkombëtare 2025 të promovojë edhe Komunën e Prizren tek pjesëmarrësit e Shkollës Verore Ndërkombëtare 2025, sidomos tek stafi dhe studentët ndërkombëtar si dhe të mbështesë komunën, me ekspertizë profesionale sipas nevojës.

Neni 3

Angazhimi në përmbushjen e marrëveshjes

Palët pajtohen që të angazhohen dhe të krijojnë një komunikim të rregullt për të përmbushur me saktësi objektin e kësaj marrëveshje.

Neni 4 **Mirëbesimi**

1. Palët pajtohen që kjo marrëveshje, të zbatohet në mirëbesim, duke ju përgjigjur obligimeve konkrete.
2. Komuna e Prizren dhe Universiteti "Ukshin Hoti" në Prizren, duke promovuar parimin e mirëbesimit në zbatimin e kësaj marrëveshje pajtohen që të zgjerojnë bashkëpunimin në të ardhmen edhe në dimensione tjera, me qëllim të promovimit të Universitetit "Ukshin Hoti" si institucion i arsimit të lartë si dhe të promovimit të objektivave të komunës, ndërlidhur me nevojat në fushën e ekspertizës profesionale që ofron Universiteti.

Neni 5 **Zbatimi**

1. Palët pajtohen që pas nënshkrimit të kësaj marrëveshje, të ndërmarrin veprime konkrete për zbatimin e saj.
2. Palët kanë obligim reciprok që të njoftojnë njëra tjetrën, për veprimet, aktivitetet dhe çështjet që përfshijnë zbatimin e kësaj marrëveshje.
3. Komuna e Prizren dhe Universiteti "Ukshin Hoti" në Prizren, pajtohen që me qëllim të zbatimit të kësaj marrëveshje të caktojnë personat përgjegjës kontaktues, në mënyrën që e konsiderojnë të përshtatshme. Personat përzgjedhës të caktuar nga palët, kujdesen për zbatimin e marrëveshjes.

Neni 6 **Kohëzgjatja**

Kjo marrëveshje është lidhur, në dy (2) kopje origjinale dhe vlenë vetëm për mbështetjen gjatë orgazinimit dhe kohëzgjatjes së Shkollës Verore Ndërkombëtare 2025.

Neni 7 **Hyrja në fuqi**

Kjo marrëveshje hyn në fuqi, ditën e nënshkrimit, nga të dyja palët.

Komuna e Prizren
Kryetar i Komunës
Z. Shaqir Totaj



Universiteti "Ukshin Hoti" Prizren
Rektori i Universitetit
Z. Prof. Asoc. Dr. Mentor Alishani

